

Arrestohet një person në Gjakovë, policia i gjejnë kallashnikov e granata dore



09/09/2022 20:28



Një person është arrestuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë, pasi dyshohet për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Policia njofton se me datën 09.09.2022 rreth orës 17:00, ka kryer kontroll në fshatin Dobrosh-Gjakovë, në vendbanimin e të dyshuarit S.Q.

Gjatë kontrollit në posedim të tij është gjetur një pushkë automatike AK47 (e cila është konfiskuar si provë materiale) dhe disa granata dore.

“Me datën 09.09.2022 rreth orës 17:00, në zbatim të urdhër kontrollit të lëshuar nga Gjykata, Stacioni Policor në Gjakovë mbështetur nga Njësia për Reagim të Shpejt ka kryer kontroll në fshatin Dobrosh-Gjakovë, në vendbanimin e të dyshuarit S. Q., shtetas i Republikës së Kosovës i lindur në vitin 1939. Gjatë kontrollit në posedim të tij është gjetur një pushkë automatike AK47 (e cila është konfiskuar si provë materiale) dhe disa granata dore”, njofton PK.

Pas intervistimit dhe përfundimit të procedurave tjera, me vendim të Prokurorit të Shtetit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

Artikuj të ngjashëm

September 10, 2022

Mustafa: Kurti mund ta përfundojë dialogun nëse tregon gatishmëri

September 10, 2022

Jasharaj: E vazhdojmë grevën për afat të pacaktuar deri në plotësimin...

September 10, 2022

S'ka investime kapitale nga Qeveria: Bie qarkullimi i bizneseve kosovare

September 10, 2022

Eurodeputeti austriak i kërkon pesë vendeve të BE-së ta njohin Pavarësinë...

September 10, 2022

Aksident i rëndë në Prishtinë, një person e godet me veturë...

September 10, 2022

Përfjashtimet në VV shkak u i Kodit Civil, Klinaku: Metodë jodemokratike

LAJME TË FUNDIT

